



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-III/01-22971
Datë: 07.05.2025



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Teknik/e i Higjenes dhe Mirëmbajtjes në QMF-ë Shalë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Kujdeset për pastërtinë e ordinancave, koridoreve dhe lokaleve tjera të punës në QMF-Shalë.
2. Mbledh hedhurinat në ordinancat e mjekve, infermerve si dhe në hollin e objektit të QMF-Shalë dhe i deponon në vendin e caktuar.
3. Kujdeset për pastërtinë e nyjeve sanitare në objektin e QMF-Shalë.
4. Pastron oborrin e objektit.
5. Në ordinanca bënë pastrimin e dyshemes, mureve, dritareve dhe inventarit tjetër që gjendet në QMF-Shalë.
6. Punët e rëndomta të pastrimit i kryen çdo ditë ndërsa një herë në muaj bënë pastrimin e përgjithshëm-gjeneral të ordinancave – inventarit dhe mjeteve tjera të punës.
7. Bënë kërkesat në afat të duhur për furnizim me lëndë djegëse dhe gjatë sezonit të dimrit kujdeset për nxemjen qendrore.
8. Kryen edhe punë tjera me kërkesën e shefit/drejtorit kur është nevoja edhe në QKMF për kujdestari.

Kushtet dhe kriteret:

- Diploma e shkollës së mesme .
- Certifikata Shëndetësore jo më e vjetër se gjashtë muaj
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan jo më e vjetër se gjashtë muaj.
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime jo më e vjetër se gjashtë muaj
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë

- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- **Paga mujore për Teknik/e i Higjenes dhe Mirëmbajtjes QMF-ë Shalë:**
- Koeficienti: (grupi GJ51_CD-432 klasa GJ51 koeficienti 4.26)
- Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar.
- Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data 08.05/2025 deri me 06.06/2025 që konsiderohet si dita e fundit e konkurimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilet kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur(nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma) dhe ato nuk kthehen,ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

